

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 50, datë 23. 06. 2004

PËR

“Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”. “

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë“,

V E N D O S I :

1. Pika “2” e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 “Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë””, shfuqizohet.
2. Në rregulloren “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 22 shtohet pika 22.1 si më poshtë:

22.1 Drejtuesi i departamentit (dhe në mungesë, zëvendësi i deleguar i tij) bën vlerësimin e çdo punonjësi të tij që klasifikohet në nivelin e ulët të drejtimit çdo 6 (gjashtë) muaj.
 - b) Pikat “23.1”, “23.2” dhe “23.3” të nenit “22” bëhen përkatësisht “22.2”, “22.3” dhe “22.4”.
 - c) Në nenin “22” pika “22.4” paragrafi “jo më vonë se tre (3) ditë pas përfundimit të tremujorit,” bëhet “jo më vonë se tre (3) ditë pas përfundimit të gjashtëmujorit”.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli MEMISHA

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos IBRAHIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr.51, datë 23.06.2004

Për

“ Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes ”

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

V E N D O S I :

1. Të miratojë uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës të interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta). Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes ulet nga 6.00 për qind, në 5.75 për qind.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli MEMISHA

KRYETARI
Shkëlqim CANI